Bibël për fëmijët
paraqet

# Samaritani i Mirë



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: M. Maillot; Lazarus

Adaptuar nga: Ruth Klassen; Sarah S.

Alastair Paterson

Përkthyer nga: Arianit & Valbona Iljazi

Prodhuar nga: Bible for Children
www.M1914.org

©2020 Bible for Children, Inc.
E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori, nëse nuk do ta shitni.


"Mësues! Çfarë duhet të bëj unë, që të marr jetën e përjetshme"?


Njeriu që bëri këtë pyetje ishte një njeri i ligjit, duke u përpjekur ta
mashtrojë Jezusin.


"çfarë thotë ligji i erëndisë"? iu përgjigj Jezusi.
"Duaj Perëndinë dhe të afërmin tënd", tha burri.
"Por, kush është i afërmi im"?

Për t'ju përgjigjur pyetjes, Jezusi tregoi një histori, për një njëri që po udhëtonte nga Jerusalemi në Jeriko.



Ky njeri u sulmua nga hajdutët.




Hajdutët i vodhën gjithçka, madje i morën edhe rrobat udhëtarit të shkretë.


Ata e palgosën shumë keq, duke e lënë gjysëm të vdekur anës rrugës.


Tani, ndodhi që një prift
kaloi aty pranë.

Me siguri ai do ta ndihmojë njeriun e plagosur.




Jo! Kur ai pa njeriun e gjakosur, kaloi nga
ana tjetër e rrugës.


Shpejt, një zhurmë hapash tregoi
se një njeri tjetër po afrohej.


Ai ishte një Levit - një njeri që ndihmonte priftërinjtë në tempull.


Kur u afrua, ai e pa njeriun e plagosur, por vazhdoi rrugën e tij pa
e ndihmuar.


Më në fund, një Samaritan kaloi andej. Judenjtë i urrejnë
Samaritanët.


Njerëzit që po dëgjonin historinë e Jezusit, nuk e prisnin që një
Samaritan të ishte heroi.


Por, ai ishte. Samaritanit i erdhi keq, dhe ndaloi ta n dihmojë.



Samaritani u përkul dhe me butësi vendosi ilaç dhe fashoi plagët e të huajit.

Pastaj, ai e ndihmoi njeriun e plagosur duke e hypur mbi gomarin e tij.



Në një han buzë rruge,
Samaritani u
kujdes
gjithë natën
për atë njeri.



Në mëngjes, ai pagoi të zotin e hanit që të ...



... kujdesej për udhëtarin derisa të bëhej mirë.



Historia mbaroi. Jezusi pyeti, “Kush ishte i afërmi i njeriut të plagosur”?





Mësuesi i ligjit u përgjigj, “I afërmi i tij ishte Samaritani që tregoi mëshirë”.


“Shko, dhe bëj po ashtu edhe ti”,
, tha Jezusi. I
afërmi ynë
është kushdo
që ndodhet
në nevojë.


Ne mund të tregojmë dashuri duke ndihmuar njerëzit në nevojë. Kjo i pëlqen Perëndisë.

# Samaritani i Mirë

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Llukes 10

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u jep mendje njerëzve të thjeshtë."
Psalmet 119:130

Fund

Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëj atë! Ai do të vijë dhe do të jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.

Nëse ti beson se kjo është e vërteta, drejtoju Perëndisë kështu: Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i bërë njeri për të vdekur për mëkatet e mia, dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem, eja në jetën time dhe fali mëkatet e mia, në mënyrë që unë të kem jetë të re dhe një ditë të jem me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo, të të bindem dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë çdo ditë! Gjoni 3:16